



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 106

8 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8233 datë 25.6.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4663
Dekret nr. 8238 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4663
Dekret nr. 8239 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4664
Dekret nr. 8240 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4664
Dekret nr. 8241 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4665
Dekret nr. 8242 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4665
Dekret nr. 8243 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4666
Dekret nr. 8244 datë 2.7.2013	Për emërim gjyqtari.....	4666
Vendim i KM nr. 499, datë 1.7.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për mobilimin e vilës nr. 4, Tiranë.....	4667

Vendim i KM nr. 505, datë 30.5.2013	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Finsec” ltd dhe “Doprastav” SA, për ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e portit të jahteve në komunën Synej, Kavajë.....	4667
Vendim i KM nr. 512, datë 13.6.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, të ndryshuar.....	4668
Udhëzim i MF nr. 20, datë 17.6.2013	Për zbatimin e ligjit nr. 105/2013, datë 28.3.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”.....	4668
Urdhër i MF nr. 31, datë 25.6.2013	Për revokimin e urdhrorit nr. 9, datë 10.3.2005 të Ministrisë së Financave “Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Taibah International”, e njohur si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, i cili rezultoi i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”, të ndryshuar.....	4673
Vendim i GJK nr. 29, datë 27.6.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 25.07.2012 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Lenie, z. Astrit Bici”.....	4673
Vendim i GJK nr. 30, datë 27.6.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	4684
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Hakik Mena.....	4687
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shkëlzen Gjoni.....	4687

DEKRET
Nr. 8233, datë 25.6.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mahmut Tuğrul Fikret Nesimi Kirmizi
2. Gül Menet Ihya Nur Kirmizi
3. Ardin Sabit Dallku
4. Mehmet Haxhi Hasanaj
5. Astrit Besim Kryeziu
6. Elvis Selajdin Susuri
7. Veli Selajdin Susuri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8238, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Alkelina Gazidede emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8239, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Artur Malaj emërohet gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8240, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Altina Nasufi emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8241, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kastriot Selita emërohet gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8242, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Blerona Hasa emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8243, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Lindita Sinanaj emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8244, datë 2.7.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136 pika 4 të Kushtetutes, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70 pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Rilinda Selimi emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 499, datë 1.7.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR MOBILIMIN E VILËS NR. 4, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t'i shtohet fondi prej 27 570 126 (njetzet e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e njetzet e gjashtë) lekësh, për mobilimin e plotë të vilës nr. 4, Tiranë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, parashikuar në buxhetin e vitit 2013.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 505, datë 30.5.2013

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS "BOT", TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE "FINSEC" LTD DHE "DOPRASTAV" SA, PËR NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PORTIT TË JAHTEVE NË KOMUNËN SYNEJ, KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit si autoritet kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Finsec" ltd. dhe "Doprastav" SA si koncesionarë për ndërtimin e portit të jahteve në komunën Synej, Kavajë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 512, datë 13.6.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 7, DATË 4.1.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË
NEVOJSHËM PËR ARKËTIMIN E TAKSËS SË RENTËS MINERARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr. 7, datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Nëse subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, renta, në këtë rast, paguhet si nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, ashtu edhe nga eksportuesi. Renta, për produktin e shitur (mineral apo nënprodukt), paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit pranë drejtorisë rajonale tatimore ku subjekti është i regjistruar, duke u llogaritur në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi, ndërsa nga eksportuesi, pranë organit doganor, në çastin e eksportimit të mineralit apo nënproduktit të blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit. Eksportuesi paguan rentën minerare në doganë, për diferencën midis vlerës së rentës së përlllogaritur në bazë të vlerës së faturës së shitjes së mineralit apo nënproduktit të tij, në bazë të çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri, dhe vlerës së rentës së paguar brenda vendit, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi. Për përcaktimin e detyrimit të rentës, në këtë rast, si dokument bazë shërbejnë fatura tatimore e shitjes me TVSH zero dhe kopja e faturës së blerjes brenda vendit, së bashku me dokumentin që provon pagimin e rentës minerare për të gjithë sasinë e faturuar. Nëse eksportuesi nuk disponon faturën e blerjes brenda vendit së bashku me dokumentin e pagesës së rentës minerare, ai paguan pranë degës doganore rentën minerare për të gjithë sasinë e faturuar në faturën tatimore të shitjes me TVSH zero.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 20, datë 17.6.2013

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 105/2013, DATË 28.3.2013 “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009 “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES DHE EVN AG, STATKRAFT AS E
DEVOLL HYDROPOWER SHA, SI BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN,
FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3 të ligjit nr. 105/2013, datë 28.3.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1.1 Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe i shërbimeve, që lidhen me projektin e hidrocentralit në lumin Devoll, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit (siç janë përkufizuar në kontratën e koncesionit, të ndryshuar), do t'i nënshtrohen regjimit specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, i cili nënkupton zbatimin e mekanizmit të autofaturimit të TVSH-së për disa furnizime mallrash dhe shërbimesh, siç përcaktohet në ligjin nr. 105/2013 dhe në këtë udhëzim.

1.2 Përkufizime

“Kontraktor i nivelit 1” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të shoqërisë koncesionare, siç është emëruar nga shoqëria koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar.

“Kontraktor i nivelit 2” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të çdo kontraktori të nivelit 1 siç është emëruar nga shoqëria koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar.

“Shoqëria koncesionare” nënkupton shoqërinë Devoll Hydropower sh.a. me numër unik të identifikimit të subjektit (NIPT) K82418002C.

Termet e tjerë të përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim që i është dhënë në kontratën e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2.1 Për qëllimin e zbatimit të regjimit specifik të TVSH-së, të përcaktuar në ligjin 105/2013 dhe nenin 2.8 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar, shoqëria koncesionare emëron gjithsej deri në dyzet e pesë (45) kontraktorë të nivelit 1 dhe kontraktorë të nivelit 2, me të drejtën që më pas të zëvendësojë çdo kontraktor të nivelit 1 dhe nivelit 2 të emëruar. Kontraktorët e emëruar në çdo periudhë kohore nuk duhet të kalojnë numrin 45.

2.2 Shoqëria koncesionare depoziton pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën fillestare të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2, si dhe kopje të kontratave që shoqëria koncesionare ka lidhur me çdonjërin nga kontraktorët e nivelit 1 së bashku me kopje të certifikatës NUIS të tyre (për subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë), si dhe kopje të kontratave të lidhura mes kontraktorëve të nivelit 1 me kontraktorët e nivelit 2.

Shoqëria koncesionare depoziton pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe listat e përditësuara të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2, kohë pas kohe sipas nevojave të aktivitetit, deri sa numri i kontraktorëve në listë të arrijë 45, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2.3. Lista fillestare dhe listat e përditësuara të kontraktorëve të nivelit 1 dërgohen edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2.3 Në rast të ndonjë shtese të kontraktorëve, heqje nga lista apo zëvendësim të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2 brenda numri 45, shoqëria koncesionare duhet të paraqesë tek administrata tatimore listën e përditësuar. Këto ndryshime bëhen efektive tri javë pas dërgimit të listës së përditësuar. Lista do t'u dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rast pas rasti.

Me bërjen efektive të shtesës, heqjes nga lista apo zëvendësimit në listën e përditësuar, kontraktori i çregjistruar nga lista në fjalë për efekte të TVSH-së nuk është më objekt i regjimit specifik të TVSH-së, të rregulluar me ligjin nr. 105/2013, por i nënshtrohet tërësisht dispozitave të ligjit për TVSH-në në fuqi.

Një kontraktor i nivelit 1 ose nivelit 2 që hiqet nga lista nga ana e shoqërisë koncesionare, mund të riemërohet dhe përfshihet në listë nga shoqëria koncesionare në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 105/2013 dhe këtij udhëzimi.

2.4 Nëse shoqëria koncesionare kërkon shtimin e kontraktorëve të rinj, përveç 45 (dyzet e pesë) kontraktorëve të përmendur më lart, ajo duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit pranë DPT-së për të miratuar kontraktorët e rinj, duke paraqitur një kërkesë të argumentuar mbi nevojën e shtimit të kontraktorëve të rinj dhe duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë edhe kopje të kontratës së lidhur mes palëve.



Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale tatimore që administrojnë kontraktin e ri. DPT-ja i kthen përgjigje shoqërisë koncesionare brenda 4 javëve nga paraqitja e kërkesës. DPT-ja nuk mund të refuzojë dhënien e miratimit në mënyrë të paarsyeshme.

2.5 Nëse shoqëria koncesionare vendos për zëvendësimin e ndonjërit nga kontraktorët shtesë (mbi numrin 45) me një kontraktor tjetër, ajo i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit pranë DPT-së për të miratuar zëvendësimin me kontraktin e ri. Në kërkesën për këtë zëvendësim, shoqëria koncesionare për çdo rast duhet të shprehet edhe mbi arsyet e kërkesës për zëvendësimin e kontraktit të mëparshëm.

Edhe në këtë rast, Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale tatimore që administrojnë kontraktin e ri dhe kontraktin e zëvendësuar. DPT-ja i kthen përgjigje shoqërisë koncesionare brenda 4 javëve. DPT-ja nuk mund të refuzojë dhënien e miratimit në mënyrë të paarsyeshme. Me bërjen efektive të zëvendësimit në listën e parashikuar, kontraktori i çregjistruar nga lista në fjalë për efekte të TVSH-së nuk është më objekt i regjimit specifik të TVSH-së, të rregulluar me ligjin nr. 105/2013, datë 28.3.2013, por u nënshtrohet tërësisht dispozitave të legjislacionit të përgjithshëm për TVSH-në në fuqi.

3.1 Importimi gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër që lidhet me projektin, në atë masë që këto importe nuk janë të përjashtuara sipas ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, importuesi nuk do të ketë detyrim për pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar pranë autoriteteve doganore, që duhej kryer në lidhje me këto importe. Pra, për importimin e mallrave që nuk janë të përjashtuara në bazë të dispozitave të ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore të tij, do të zbatohet regjimi specifik i TVSH-së, i përcaktuar në ligjin nr. 105/2013 dhe në këtë udhëzim.

Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar.

Kjo pikë zbatohet vetëm ndaj importeve të kryera nga shoqëria koncesionare ose çdo kontraktor i nivelit 1.

3.2 Importuesi, sipas pikës 3.1 më sipër, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave në të njëjtën kohë (autofaturim) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre importeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë, pra nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht që importuesi të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

Fatura tatimore e përgatitur sipas kësaj pike regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjes dhe atë të shitjes së TVSH-së. Konkretisht, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja në import do të paraqitet në librin e shitjes në kolonat [11] dhe [12] "Shitje brenda vendit". Po kjo faturë do të deklarohet në librin e blerjes në kolonat [20] dhe [21] "Blerje nga furnitorë vendas me shkallë tatimore 20%".

Po ashtu, vetëm për qëllime të evidentimit të importit të kryer, dokumenti i vetëm administrativ përkatës do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve në kolonën [15] "Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH" me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë në përllogaritjen e blerjeve të shoqërisë koncesionare apo kontraktorit të nivelit 1.

3.3 Shoqërisë koncesionare apo kontraktorit të nivelit 1 i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr. 37 të DAV-it, vendoset kod shtesë për (regjimin specifik të TVSH-së sipas ligjit 105/2013). Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet një numër i veçantë nga administrata doganore, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu, në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit shënimi "Import sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit nr. 105/2013, referuar deklaratës doganore nr. ___/datë ___".

3.4 Kontraktori i nivelit 1 ose shoqëria koncesionare sipas këtij udhëzimi, kur kryen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore paraqet:

- a) një kërkesë me shkrim për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi;
- b) fotokopje të certifikatës së NUIS;

c) kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë koncesionare, ku jepen detaje për mallrat, sasitë dhe degët e kontraktit 1, që janë potencialisht furnizuese të mallit që do të importohen.

3.5 Trajtimi i importeve, siç përcaktohet më sipër në pikat 3.1 deri 3.4, nuk ndikon tek e drejta e importuesit për të zbritur TVSH-në në blerje (mbi bazën e autofaturës së lëshuar prej tij në përputhje me pikën 3.2 më sipër) njësoj sikur importi i kryer prej tij të ishte një importim i tatueshëm me TVSH, sipas rregullave të përgjithshme të TVSH-së.

4.1 Për shërbimet e lidhura me projektin, duke përfshirë këtu edhe shërbimet që lidhen me pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, të cilat janë subjekt i TVSH-së në Republikën e Shqipërisë, që kryhen nga furnitorë të huaj, persona të tatueshëm që nuk kanë vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri dhe të cilët nuk janë të regjistruar për qëllim të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së pranë administratës tatimore në Shqipëri, të kryera nga vetë furnitori i huaj ose dega e saj për shoqërinë koncesionare ose për një kontraktor të nivelit 1, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, vetëm personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet do të jetë përgjegjës për pagesën pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t'u paguar në lidhje me këto shërbime.

Këto shërbime do të trajtohen si shërbime të kryera nga personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet, për veten e tij si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike (autofaturim), me efekt lindjen e detyrimit të personit, të cilit i janë furnizuar shërbimet për të deklaruar si të pagueshëm tatimin mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për ta zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar, përveçse kur zbritja (kreditimi) i tatimit nuk lejohet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në. Pra, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, shoqëria koncesionare ose kontraktori i nivelit 1 do të jenë përgjegjës për llogaritjen dhe deklarimin e TVSH-së për shërbimet e marra përfshirë edhe shërbimet që lidhen me pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, të lidhura me projektin, të cilat janë subjekt i TVSH-së në Republikën e Shqipërisë dhe që kryhen nga tatimpagues të përgjithshëm në Shqipëri, pa pasur nevojën që këta të fundit të regjistrohen vetë në Shqipëri apo të emërojnë një përfaqësues tatimor në Shqipëri, për efekt të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së.

5.1 Për furnizimet brenda vendit të makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër të lidhura me projektin, si edhe të të gjitha shërbimeve, të lidhura me projektin gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, vetëm personi, të cilit i janë kryer furnizimet do të jetë përgjegjës për deklarimin si të pagueshëm të TVSH-së pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t'u paguar në lidhje me këto furnizime dhe do të ketë të drejtë ta zbresë këtë tatim mbi vlerën e shtuar nëpërmjet procesit të autofaturimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për TVSH-në. Në këtë rast në faturat e lëshuara nga furnizuesi për furnizimet, nuk llogaritet apo pasqyrohet TVSH-ja. Trajtimi në këtë mënyrë i furnizimeve, nuk ndikon tek e drejta e furnizuesit për të zbritur TVSH-në në blerje njësoj sikur furnizimi i tij të ishte një furnizim i tatueshëm me TVSH, sipas rregullave të përgjithshme të TVSH-së.

Kjo procedurë është e zbatueshme vetëm për furnizime të kryera nga kontraktorët e nivelit 1 dhe kontraktorët e nivelit 2.

Përfituesi i këtyre furnizimeve, që sipas rastit do të jetë shoqëria koncesionare ose kontraktori i nivelit 1, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturim) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë, pra nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht që personi, të cilit i janë kryer furnizimet, të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në.



5.2 Furnizimet e kryera ndërmjet një pale të tretë dhe një kontraktori të nivelit 2 kur ky i fundit është përfituesi (blerësi) i mallrave apo i shërbimeve dhe, pavarësisht nëse ato janë të lidhura me projektin apo kryhen gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, nuk janë subjekt i regjimit specifik të TVSH-së sipas këtij udhëzimi. Këto furnizime iu nënshtrohen dispozitave të ligjit për TVSH-në dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

5.3 Për furnizimet e kryera nga kontraktori i nivelit 2 ndaj kontraktorit të nivelit 1, kontraktori i nivelit 2, do të lëshojë një faturë tatimore, duke mos llogaritur apo deklaruar TVSH-në në faturë, pasi furnizimet e kryera nga kontraktori i nivelit 2 janë të tatueshëm me TVSH, por detyrimin për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e TVSH-së për këto furnizime e mban përfituesi (blerësi) i këtyre furnizimeve. Kontraktori i nivelit 2 do ta regjistrojë faturën e shitjeve në librin e shitjeve në kolonën [10] “Eksporte/furnizime me 0%”.

5.4 Për vlerën e furnizimeve të furnizuara nga kontraktori i nivelit 2, sipas faturës së lëshuar në përputhje me paragrafin 5.3, kontraktori i nivelit 1 do të lëshojë një faturë tatimore shitje për veten ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturim). Vlerën e tatueshme dhe TVSH-në e paraqitur në këtë faturë, kontraktori i nivelit 1 do ta deklarojë në librin e blerjes përkatësisht në kolonën [20] dhe [21] “Blerje brenda vendit me shkallë tatimore 20%”, me kusht që kontraktori i nivelit 1 ka të drejtë të zbrësë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në. Në të njëjtën kohë vlera e tatueshme dhe TVSH-ja do të deklarohen në librin e shitjes në kolonën [11] dhe [12] “Shitje brenda vendit me shkallë tatimore 20%”.

5.5 Vetëm për qëllime të evidentimit dhe të rakordimit nga administrata tatimore, fatura tatimore e lëshuar nga kontraktori i nivelit 2 do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve të kontraktorit të nivelit 1 në kolonën [15] “Blerje të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH”, me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë në përlllogaritjen e blerjeve totale të kontraktorit të nivelit 1.

5.6 E njëjta procedurë do të zbatohet për furnizimet e kontraktorit të nivelit 1 të kryera për shoqërinë koncesionare. Në faturën e lëshuar nga kontraktori i nivelit 1 për shoqërinë koncesionare nuk do të llogaritet dhe pasqyrohet TVSH-ja. Kontraktori i nivelit 1 do të deklarojë këtë faturë në librin e shitjeve në kolonën [10] “Eksporte/furnizime me 0%”. Shoqëria koncesionare do të lëshojë faturë tatimore shitjeje për vete (autofaturim), e cila do të deklarohet në librat e TVSH-së, siç përcaktohet në paragrafin 5.4 më sipër.

5.7 Trajtimi i furnizimeve, siç përcaktohet në pikat 5.1 deri 5.8, nuk ndikon tek e drejta e furnizuesit për të zbritur TVSH-në në blerje njësoj sikur furnizimi i tij të ishte një furnizim i tatueshëm me TVSH sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në.

6. Faturat shtesë (saktësuese) të lëshuara në përputhje me nenin 29 të ligjit për TVSH-në do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë, si dhe faturat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzimi. Faturat e lëshuara në zbatim të nenit 13 të ligjit për TVSH-në për paradhënie do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë, si edhe faturat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

7. Shoqëria koncesionare, kontraktori i nivelit 1 apo kontraktori i nivelit 2 nëse kryejnë furnizime të mallrave apo shërbimeve për palë të treta për të cilat nuk zbatohet regjimi specifik i TVSH-së, siç përcaktohet në këtë udhëzim, do të lëshojnë faturë tatimore në përputhje me dispozitat e ligjit për TVSH-në.

8. Nëse furnizimet brenda vendit të mallrave apo të shërbimeve të kryera nga kontraktori i nivelit 1 apo kontraktori i nivelit 2 janë të përjashtuara nga TVSH-ja sipas dispozitave të ligjit për TVSH-në (përveç furnizimit të përcaktuar në pikën 2.C të shtesës së 2-të të kontratës së koncesionit, të miratuar me ligjin 105/2013), atëherë për këto furnizime nuk zbatohen dispozitat e këtij udhëzimi, pra ky shërbim nuk autofaturohet nga përfituesi i furnizimit.

9. Ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorja e Përgjithshme e Doganave për marrjen e masave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr. 31, datë 25.6.2013

PËR REVOKIMIN E URDHËRIT NR. 9, DATË 10.3.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “TAIBAH INTERNATIONAL”, E NJOHUR SI SHOQATA NDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCVESVE TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 121 pika 1, 124 dhe 125 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999”,

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 9, datë 10.3.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Taibah International”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”, të ndryshuar me urdhrat nr. 20, datë 13.6.2006 dhe nr. 29, datë 5.7.2006.

2. Ky revokim përfshin të gjitha fondet, llogaritë, asetet, pasuritë e paluajtshme, trojet, investimet në shoqëri tregtare dhe mjetet financiare në emër të fondacionit “Taibah International”, e njohur si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave të sekuestruara me urdhrat e parashikuar në pikën 1.

3. Për lirim dhe dorëzimin e pasurive të revokuara me këtë urdhër, të ngrihet një grup pune në përbërje të të cilit të ketë përfaqësues nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr. 29, datë 27.6.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtari	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtari	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtari	“	“
Admir Thanza	Anëtari	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtari	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datat 22 dhe 23.11.2012, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen nr. 36/11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Astrit Bici, përfaqësuar nga avokati Koli Bele, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 25.07.2012 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Lenie, z. Astrit Bici”.



BAZA LIGJORE: Neni 115/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Astrit Bici është zgjedhur kryetar i komunës Lenie, rrethi Gramsh, qarku Elbasan, në zgjedhjet për pushtetin vendor, të zhvilluara në vitin 2011.

2. Në vitin 2012, në zbatim të programit të kontrollit nr. 453/1, datë 06.04.2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka kryer auditimin në këtë komunë. Periudha e kontrollit ka përmbledhur aktivitetin ekonomik e financiar për harkun kohor nga data 01.01.2010 deri në datën 31.12.2011.

3. Pas miratimit të aktit përfundimtar të kontrollit, me shkresën nr. 453/9, datë 30.06.2012, KLSH-ja i ka propozuar Këshillit të Ministrave marrjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për kryetarin e komunës Lenie, Astrit Bici.

4. Në bazë të konkluzioneve të raportit të auditimit të KLSH-së, Ministri i Brendshëm ka përgatitur relacionin për projektvendimin “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Lenie, z. Astrit Bici”.

5. Me vendimin nr. 458, datë 25.07.2012 të Këshillit të Ministrave, kërkuari është shkarkuar nga detyra për shkelje të rënda të ligjit, në mbështetje të neneve 100/2 dhe 115 të Kushtetutës dhe nenit 42, shkronja “a” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

II

6. **Kërkuari Astrit Bici** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e datës 23.08.2012, për shfuqizimin e vendimit të mësipërm, duke parashtruar këto shkaqe:

6.1 Shkarkimi i kërkuarit është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, pasi ai nuk është njohur me shkeljet e atribuara, me arsyet e shkarkimit, si dhe nuk i është dhënë e drejta të mbrohet para organit procedues. Vendimi i kundërshtuar i është komunikuar kërkuarit vetëm me një shkresë përcjellëse, pa iu bashkëlidhur motivacioni i detajuar apo ndonjë relacion i mundshëm për shkeljet e rënda të ligjit si dhe mënyrën se si Këshilli i Ministrave i konstatoi ato.

6.2 Kërkuari nuk është njoftuar për fillimin e procedurës për shkarkim dhe as për ndonjë propozim të KLSH-së ose Ministrit të Brendshëm lidhur me shkarkimin e tij. Duke qenë se marrëdhënia e kërkuarit me organin që e shkarkon nuk është marrëdhënie varësie, mosnjoftimi dhe mosdëgjimi i tij lidhur me shkeljet e atribuara është në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor.

6.3 Prapësimet që subjekti i audituar (komuna Lenie) ka bërë ndaj raportit të kontrollit, kanë pasur për objekt auditimin e performancës së këtij subjekti dhe kjo procedurë nuk mund të barazohet me procedimin disiplinor që kryen organi administrativ.

6.4 Edhe pse KLSH-ja ka konstatuar shkelje me karakter administrativ në çdo bashki e komunë të kontrolluar, rezulton se vetëm për kërkuarin është propozuar masa disiplinore “shkarkim nga detyra”. KLSH-ja, si organi që ka kryer kontrollin dhe ka propozuar marrjen e masës disiplinore, nuk ka respektuar standardet e kontrollit dhe ka shfaqur njëanshmëri të dukshme.

6.5 Ligjvënësi nuk ka dhënë një përkufizim apo listim shterues të shkeljeve ligjore që konsiderohen shkelje të rënda të ligjit. Duke pasur parasysh konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH-së për komunën Lenie, rezulton se në asnjë rast nuk përmendet termi “shkelje e rëndë e ligjit”, por janë konstatuar shkelje të ndryshme që kanë të bëjnë me elemente të menaxhimit dhe të fushës financiare, të

cilat nuk janë vendimmarrje individuale të kryetarit të komunës. Për më tepër, kërkuesi ka marrë të gjitha masat, rast pas rasti, për zhdëmtimin apo kthimin e shumave të rekomanduara.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka parashtruar këto shkaqe për rrëzimin e kërkesës:

7.1 Vendimi i kundërshtuar ka respektuar kriteret kushtetuese që lidhen me vlefshmërinë formale të vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, bazuar në nenin 100 të Kushtetutës. Ky vendim përmbush edhe standardin e arsyetimit të tij, pasi shoqërohet nga relacioni shpjegues, i cili përmban të gjitha elementet formale të kërkuara nga ligji.

7.2 Pretendimi i kërkuesit se nuk është vënë në dijeni për iniciimin e procedurës së shkarkimit ndaj tij dhe se i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur, nuk qëndron. Kërkuesi është njohur me procesin e kontrollit të ushtruar nga KLSH-ja, objektin, gjetjet dhe identifikimin e autorësisë konkrete dhe mundësinë e kundërshtimit të fakteve dhe burimit të nxjerrjes së tyre. Në këtë kuptim, standardi i procesit të rregullt është realizuar më së miri nga grupi i inspektorëve të KLSH-së. Propozimi për shkarkim nga KLSH-ja, përcjellja e materialit në Ministrinë e Brendshme, propozimi për shkarkim dhe miratimi i vendimit nga Këshilli i Ministrave janë hallka procedurale që marrin shkas prej shkakut ekskluziv dhe determinant që është shkelja e rëndë e ligjit.

7.3 Pretendimi se nuk është zbatuar parimi i kontradiktoritetit, pasi kërkuesi nuk ka mundur të japë arsyet e veta ndaj VKM-së që e ka shkarkuar, nuk qëndron. Kërkuesi ka pasur të gjitha mundësitë dhe i ka shfrytëzuar ato për të kundërshtuar gjetjet e kontrollit të KLSH-së. Vetë kërkuesi nuk pretendon që Këshilli i Ministrave të ketë bazuar vendimin e tij në fakte e rrethana të tjera jashtë këtij kontrolli. Kontradiktoriteti si mekanizëm ka ekzistuar, porse është zhvilluar i "shfazuar", kjo pasi nuk ka sesi të ketë një seancë formale të zhvilluar prej dhe para Këshillit të Ministrave, përpara votimit, për të dëgjuar dhe njëherë pretendimet e kërkuesit.

7.4 Këshilli i Ministrave ka respektuar të gjitha detyrimet kushtetuese në drejtim të procedurës, të urdhëruara nga nenet 100 dhe 115 të Kushtetutës. Shkaku për të cilin është vendosur shkarkimi i kërkuesit është "për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve", i parashikuar në nenin 42, shkronja "a" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Për sa kohë që është vërtetuar nga KLSH-ja, si organi kushtetues i pavarur dhe, njëherazi, organi shtetëror më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar, që kërkuesi ka shkelur ligjin me pasojë dëmtimin ekonomik të buxhetit të shtetit, vërtetohet se prej tij është kryer shkelje e rëndë e Kushtetutës dhe ligjit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin racione temporis të kërkuesit

8. Fillimisht, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se duhet të ndalet në verifikimin e legjitimitimit *racione temporis* të kërkuesit Astrit Bici për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues. Bazuar në nenin 115/2 të Kushtetutës, organi i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet. Gjykata ka theksuar se njoftimi i aktit të shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore dhe fillimi i afatit kohor për ankimin administrativ kundër këtij akti duhet të mbështeten në rregullat e përgjithshme ligjore, sipas Kodit të Procedurave Administrative (KPA), për njoftimin e akteve administrative me karakter individual (*shih vendimin nr. 15, datë 08.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se VKM-ja nr. 458, datë 25.07.2012, i është dërguar për dijeni prefektit të qarkut Elbasan dhe këshillit të komunës Lenie, me shkresën e datës 06.08.2012, kurse data e shënuar në shkresën përcjellëse të vendimit, si data e regjistrimit të saj, është 09.08.2012. Kërkuesi e ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese në datën 23.08.2012. Gjykata është shprehur në jurisprudencë të vazhdueshme se, për efekt të legjitimitimit të kërkuesit, si datë e fillimit të afateve të ankimit ndaj aktit individual që cenon të drejtat e personit objekt i këtij akti, do të konsiderohet data e marrjes dijeni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit (*shih vendimet nr. 39, datë 29.12.2005; nr. 30, datë 28.12.2006; nr. 22, datë 07.10.2008; nr.*



15, datë 08.06.2009; nr. 15, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, si datë e marrjes dijani vlerësohet data e mbërritjes së vendimit të shkarkimit pranë këshillit të komunës Lenie, që është data 09.08.2012. Duke iu referuar kësaj date, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka respektuar afatin 15-ditor të ankimit dhe, pra, legjitimohet *ratione temporis*.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor

10. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për arsye se Këshilli i Ministrave, gjatë procesit të vendimmarrjes, nuk ka respektuar kërkesat e KPA-së, për sa i përket iniciimit të procedimit administrativ, njoftimit të personit që preket nga ky procedim dhe procedurave të marrjes së vendimit.

11. Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimin nr. 76, datë 25.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim Gjykata ka vlerësuar se nëse kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë kontrolleve të ushtruara nga organet e kontrollit, ka paraqitur kundërshtimet e veta rreth shkeljeve të përmendura në to, dhe janë vetëm këto shkelje mbi të cilat është bazuar propozimi dhe vendimi për shkarkimin e tij, nuk kemi cenim të së drejtës për t'u mbrojtur (*shih vendimet nr. 30, datë 28.12.2006, nr. 15, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në të njëjtën linjë me jurisprudencën e saj, Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar. Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ky organ ka si objekt kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e miradministrimit financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare. Bazuar në nenin 16 të po këtij ligji, KLSH-ja ka të drejtë të kërkojë nga subjektet e kontrolluara marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes, në përputhje me rekomandimet e kontrollit, si dhe të kërkojë nga subjektet e kontrolluara, ose nga autoritetet më të larta shtetërore, marrjen e masave të zhdëmtimit dhe disiplinore, në përputhje me ligjet përkatëse, ndaj personave që kanë shkaktuar dëme direkte ose indirekte. Subjektet e kontrolluara kanë mundësinë që të bëjnë vërejtje për projektraportin e kontrollit para publikimit të tij dhe vërejtjet e bëra pasqyrohen në raportin përfundimtar.

14. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi ka marrë dijani dhe ka qenë i pranishëm gjatë kontrollit të ushtruar nga KLSH-ja, është njohur me përfundimet e këtij kontrolli, si dhe ka pasur mundësinë të paraqesë observacionet e tij lidhur me problemet e konstatuara nga grupi i kontrollit, të evidentuara më pas në aktin përfundimtar të kontrollit. Në raportin përfundimtar të KLSH-së janë parashikuar edhe masat organizative dhe masat për shpërblim dëmi që duhet të ndërmerren nga subjekti i audituar dhe afati për realizimin e detyrave të lëna. Pas përfundimit të kontrollit dhe hartimit të raportit përfundimtar, KLSH-ja ka paraqitur propozimin për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, duke listuar edhe shkeljet e konstatuara nga ky organ. Pas njohjes me konkluzionet e KLSH-së, Ministri i Brendshëm, duke i konsideruar ato të mjaftueshme për të konkluduar shkeljen e rëndë të ligjit nga ana e kryetarit të komunës, ka përgatitur relacionin dhe projektvendimin për shkarkim, i cili është miratuar nga Këshilli i Ministrave.

15. Siç u theksua më sipër, e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e të drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur. Gjykata vëren se neni 44 i KPA-së, parashikon se çdokush që ka interes të ligjshëm ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ. Palët pjesëmarrëse në një procedim

administrativ janë autoriteti kompetent nga njëra anë dhe pala e interesuar nga ana tjetër. Megjithatë, procedimi administrativ nuk zhvillohet përherë në prani të palëve të interesuara dhe jo çdo herë kjo e fundit mund të shprehet lidhur me procedimin. Neni 96 i KPA-së parashikon rastet kur përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur, mes të cilave edhe kur palët e interesuara kanë pasur rast t'i japin mendimet e tyre për çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit. Në rastin konkret, vendimi për shkarkimin e kërkuesit nga detyra është bazuar vetëm mbi shkeljet e konstatuara nga ana e KLSH-së dhe, duke qenë se kërkuesi është njohur paraprakisht me to dhe i është dhënë mundësia që, gjatë procedurës së kontrollit, të parashtrijë të gjitha pretendimet dhe argumentet e veta lidhur me konkluzionet e aktit të kontrollit, konsiderohet se ai e ka shprehur mendimin/qëndrimin e tij lidhur me thelbin e shkeljeve të konstatuara, që janë bërë shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

16. Gjykata vëren, gjithashtu, se në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutëbërësi, në mënyrë që t'u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115/2 të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ (*shih vendimet nr. 39, datë 29.12.2005; nr. 22, datë 07.10.2008; nr. 15, datë 08.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, si organi i vetëm që shqyrton ankesën e organit të qeverisjes vendore, e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural dhe, duke respektuar standardet e një procesi të drejtë ligjor, i krijon kërkuesit mundësinë e mbrojtjes nëpërmjet paraqitjes së provave dhe argumenteve të veta (*shih vendimin nr. 30, datë 28.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë gjykim, secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Pala kërkuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar ka detyrimin të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 22, datë 07.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se një garanci tjetër për organin e qeverisjes vendore është edhe parashikimi, në po këtë dispozitë kushtetuese, për pezullimin e efekteve të vendimit të shkarkimit/shpërndarjes deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e kësaj Gjykate.

17. Në lidhje me pretendimin për mungesën e arsytimit të vendimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se sipas nenit 109 të KPA-së, arsytimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsytimi është bërë në informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsytim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar dhe, në këto raste, informacionet dhe propozimet e mëparshme janë pjesë përbërëse e aktit. Gjykata konstaton se, nga pjesa hyrëse e vendimit të kundërshtuar rezulton se ai është bazuar në relacionin dhe propozimin e Ministrit të Brendshëm, ndërsa relacioni i këtij të fundit bazohet në informacionet e dërguara nga organi i kontrollit, për të cilat kërkuesi është vënë në dijeni dhe ka paraqitur argumentet e veta. Gjykata vlerëson se, edhe pse relacioni i Ministrit të Brendshëm që shoqëron projekt vendimin për shkarkim dhe vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton shkarkimin e organit të zgjedhur të njësisë së qeverisjes vendore i përkasin dy organeve të ndryshme, ato janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe përfaqësojnë një proces të pandashëm. Në relacionin e Ministrit të Brendshëm, i cili, bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", është pjesë e pandarë e përmbajtjes së vendimit të shkarkimit, rezulton i pasqyruar i gjithë informacioni mbi faktet që janë bërë shkas për nxjerrjen e tij dhe që, në vlerësimin e Ministrit të Brendshëm, kanë përligjur shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar është i arsytuar, në përputhje me nenin 109 të KPA-së.

C. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 115 të Kushtetutës

18. Kërkuesi pretendon se është shkarkuar nga detyra e kryetarit të komunës në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115/1 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka kryer sjellje dhe akte që bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjin.

19. Bazuar në nenin 115, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, Gjykata është organi që shqyrton ankimin kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin ose shpërndarjen e organit të qeverisjes vendore. Gjykata është shprehur se një gjykim i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të



qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës dhe ajo, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës apo ligjit, heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimet nr. 39, datë 29.12.2005; nr. 22, datë 07.10.2008; nr. 15, datë 08.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në nenin 115, pika 1, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave mund të shkarkojë organin e zgjedhur drejtpërdrejt të njësisë qeverisëse vendore, për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Përmbajtja e kësaj dispozite është reflektuar në nenin 42, shkronja “a”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ligji 8652). Gjykata vlerëson se, për shkak të kompetencave mjaft të gjera që u janë dhënë organeve të zgjedhura drejtpërdrejt të qeverisjes vendore, bartësve të këtyre funksioneve u njihet edhe një përgjegjësi po aq e madhe. Shkarkimi nga detyra apo shpërndarja e organeve të qeverisjes vendore është shprehje e kontrollit që ushtrohet mbi këto organe dhe, në këtë kuptim, neni 115 i Kushtetutës kërkon ekzistencën e shkeljeve që jo vetëm të konsiderohen të rënda, por edhe që t’i ngarkohen drejtpërdrejt organit të shkarkuar/shpërndarë. Duke qenë se shkarkimi/shpërndarja e organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore është një masë ekstreme e procedurave të kontrollit, ajo duhet të merret pas një vlerësimi të kujdesshëm të disa elementeve, të elaboruara në jurisprudencën e kësaj Gjykate, sipas së cilës kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit vlerësohet në tërësinë e tij nga disa faktorë, të cilët kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij, kohëvazhdimin e këtyre pasojave si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer (*shih vendimet nr. 75, datë 19.04.2002; nr. 22, datë 07.10.2008; nr. 15, datë 08.06.2009; nr. 15, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga materialet e kësaj çështjeje rezultojnë se shkeljet e rënda të ligjit, të atribuara kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur, janë: me veprime dhe mosveprime ka dëmtuar funksionimin normal të institucionit; me veprime dhe mosveprime ka dëmtuar buxhetin e shtetit apo/dhe i ka sjellë dëm ekonomik buxhetit të komunës; ka përfutuar shuma monetare që lidhen me shpenzimet në telefoni celularë; nuk ka zbatuar rekomandimet e auditimit të prefektit dhe nuk ka ekzekutuar detyrimet e prapambetura; nuk ka prezantuar gjendjen e konfliktit të interesit ndërmjet tij dhe kryetarit të këshillit të komunës që është xhaxhai i tij etj.

22. Lidhur me rëndësinë e ligjit të shkelur dhe pasojat e ardhura, Gjykata vëren se shkeljet e konstatuara, pa u ndalur konkretisht në secilën prej tyre, kanë të bëjnë me çështje që lidhen me menaxhimin financiar, menaxhimin e riskut, përgatitjen e projektbuxheteve dhe zbatimin e ndjekjen e buxhetit, mbajtjen e dokumentacionit kontabël, procedurat e prokurimit, kontrollin e punimeve të ndërtimit, menaxhimin e të ardhurave të komunës, programet e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave vendore, shpenzimet e telefonisë celulare dhe dieta etj. Ato, kryesisht, janë të karakterit teknik dhe jo vetëm që nuk i ngarkohen në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkuesit por, në varësi të shkeljes konkrete, zyrës së financës, komisioneve përkatëse (komisioni i prokurimit, komisioni i biletave, komisioni i inventarizimit) si dhe punonjësve të tjerë të komunës, por as nuk kanë sjellë pasojat të rënda në veprimtarinë e kësaj komune dhe funksionimin normal të saj, që të kenë penguar apo paralizuar punën e këshillit apo të komunës, të kenë krijuar vështirësi në veprimtarinë e organeve të kësaj njësie të qeverisjes vendore dhe në ushtrimin e funksioneve të saj në të mirë të komunitetit.

23. Si shkelje e kryer nga kërkuesi është paraqitur, gjithashtu, mosprezantimi i konfliktit të interesit ndërmjet tij, në cilësinë e kryetarit të komunës, dhe z. Çelnic Bici (xhaxhai i tij), në cilësinë e kryetarit të këshillit të komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Lidhur me këtë shkelje, rezultojnë se në relacionin e KLSH-së drejtuar Këshillit të Ministrave dhe në relacionin e Ministrisë të Brendshme, ajo është paraqitur si një shkelje më vete, kurse në aktin e kontrollit të KLSH-së është paraqitur si element i shkeljes që lidhet me dhënien e shpërblimit për shtetasin Çelnic Bici. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 109 të Kushtetutës, organet përfaqësuese dhe ekzekutive në komuna e bashki zgjidhen me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë, sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor. Sipas nenit 36 të ligjit 8652, kryetari i këshillit komunal ose bashkiak zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit. Sipas nenit 25 të po këtij ligji, funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

funksionin e kryetarit, zëvendëskryetarit të komunës ose bashkisë; funksionin e sekretarit të këshillit komunal ose bashkiak; funksionin e nëpunësit të administratës së komunës ose bashkisë përkatëse; funksionin e deputetit. Po ashtu, nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen dhe dhëndrin. Gjykata, bazuar në dispozitat e mësipërme të ligjit 8652, si dhe bazuar në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” vlerëson se në rastin konkret nuk konstatohet ekzistenca e konfliktit të interesit midis kërkuesit, në cilësinë e kryetarit të komunës, dhe xhaxhait të tij, në cilësinë e kryetarit të këshillit të kësaj komune, pra nuk konstatohet ekzistenca e konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve të veta.

24. Lidhur me kohëvazhdimin e këtyre pasojave, Gjykata vlerëson se edhe pse kërkuesit i janë dhënë rekomandime të shumta nga KLSH-ja, nuk është verifikuar nga asnjëri nga organet e përfshira në këtë procedurë nëse ai i ka zbatuar ose jo ato, si dhe nuk i është dhënë koha e mjaftueshme për këtë qëllim.

25. Si pjesë e kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit nga detyra të kërkuesit, kjo Gjykatë shqyrton edhe qëndrimin subjektiv të kërkuesit ndaj shkeljes së atribuar. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në observacionet e subjektivit të audituar (komuna Lenie) drejtuar KLSH-së, për sa i përket menaxhimit financiar janë pranuar mangësitë dhe është arsyetuar se ka vështirësi në kuptimin dhe asimilimin e legjislacionit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si pasojë e nivelit të pamjaftueshëm financiar. Po ashtu, në parashtrimet drejtuar Gjykatës, si dhe seancën plenare të zhvilluar para kësaj Gjykate, kërkuesi u shpreh se nuk e ka shmangur veten nga përgjegjësia, por se shkeljet e konstatuara nuk janë të asaj shkalle që të justifikojnë shkarkimin e tij. Ai u shpreh edhe se ka marrë masat përkatëse, duke vlerësuar rekomandimet për zhdëmtimin apo kthimin e shumave të rekomanduara.

26. Gjykata vëren se, nga materialet e çështjes rezulton se, pas miratimit të aktit të kontrollit, KLSH-ja i është drejtuar Këshillit të Ministrave me propozim për marrjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për kërkuesin, i cili i është përcjellë për kompetencë Ministrisë të Brendshme, me shkresën e datës 24.07.2012. Po në këtë datë, Ministri i Brendshëm i ka dërguar Këshillit të Ministrave, për miratim, projektvendimin për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, i cili është miratuar një ditë më pas, në datën 25.07.2012. Gjykata vlerëson se, edhe pse ligji i ka njohur KLSH-së, ashtu si dhe organeve të tjera kontrolluese, të drejtën të kërkojë marrjen e masave disiplinore, rekomandimet/propozimet e këtij organi nuk janë detyruese për organet të cilave u drejtohen. Ministri i Brendshëm, i cili përgatit relacionin shoqërues të vendimit të Këshillit të Ministrave, kishte detyrimin të vlerësonte nëse shkeljet e ligjit të konstatuara nga KLSH-ja janë të tilla që të konsiderohen si “shkelje të rënda”, në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës dhe nenit 42/a të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Ai duhet të kryente një analizë të thellë dhe të detajuar të pasojave të ardhura nga secila shkelje, në kuptim të kompetencave dhe përgjegjësi të organeve përfaqësuese të qeverisjes vendore, dhe nuk mund të ndalej vetëm në citimin e disa ligjeve. Përkundrazi, të gjitha shkeljet e konstatuara nga KLSH-ja janë konsideruar *a priori* shkelje të rënda të ligjit të kryera nga kërkuesi dhe, si të tilla, janë vënë në bazë të vendimmarrjes për shkarkimin e tij nga detyra. Siç u theksua edhe më sipër në vendim, edhe pse procedura e shkarkimit të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore kërkon investimin e dy organeve, Ministrisë të Brendshme që përgatit relacionin shoqërues të projektvendimit për shkarkim dhe Këshillit të Ministrave që miraton shkarkimin, ajo përfaqëson një proces të pandashëm.

27. Si përfundim, Gjykata vlerëson se shkeljet që i janë ngarkuar kërkuesit Astrit Bici nuk janë të rënda, në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës dhe, për pasojë, vendimi i Këshillit të Ministrave nuk respekton marrëdhënien e proporcionalitetit midis shkeljeve të konstatuara dhe masës së dhënë ndaj kërkuesit, shkarkimit të tij nga detyra e kryetarit të komunës Lenie, Gramsh.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës¹
 - Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 25.07.2012 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Komunës Lenie, z. Astrit Bici”.
 - Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
- Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha.
- Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Admir Thanza.

MENDIM PARALEL

Në këtë çështje pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin e VKM-së nr. 458, datë 25.07.2012, “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Komunës Lenie, z. Astrit Bici”, por çmoj se shfuqizimi i këtij vendimi duhej të mbështetej në argumentin se ky akt është marrë nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor.

Shumica, në këtë çështje, pretendimit të kërkuarit se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi ai nuk është njohur me shkeljet e atribuara, me arsyet e shkarkimit si dhe nuk i është dhënë e drejta të mbrohet para organit procedues, i ka dhënë përgjigje duke vlerësuar se kërkuari ka marrë dijeni dhe ka qenë i pranishëm gjatë kontrollit të ushtruar nga KLSH-ja, është njohur me përfundimet e këtij kontrolli dhe ka paraqitur observacionet e tij në lidhje me to. Shumica, në arsyetimin e saj, ka çmuar se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta për t’u mbrojtur, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për t’u njoftuar dhe as ajo për të pasur një vendim të arsyetuar, duke arritur në konkluzionin se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor është i pabazuar.

Ndryshe nga shumica, vlerësoj se ky pretendim i kërkuarit është i bazuar dhe duhej pranuar për arsyet në vijim.

Ashtu siç ka pranuar edhe shumica, e drejta për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por shtrihet edhe në atë me karakter disiplinor administrativ, siç është rasti në shqyrtim. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt ligjor, cenimin e së cilës, Gjykata Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 76, datë 25.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutëbërësi, në mënyrë që t’u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115/2 të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t’u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata, si organi i vetëm që shqyrton ankesën e organit të qeverisjes vendore, e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural dhe, duke respektuar standardet e një procesi të drejtë ligjor, i krijon kërkuarit mundësinë e mbrojtjes nëpërmjet paraqitjes së provave dhe argumenteve të veta. Në këtë gjykim, secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Pala kërkuuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar ka detyrimin të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr. 39, datë 29.12.2005; nr. 30, datë 28.12.2006; nr. 22, datë 07.10.2008; nr. 15, datë*

¹ Gjyqtari S. Berberi votoi pro pranimit të kërkesës, por me argumente të tjera.

08.06.2009, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata, gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit të organit të qeverisjes vendore, sipas nenit 115 të Kushtetutës, fillimisht, duhet të vlerësojë nëse organi procedues, Këshilli i Ministrave, i ka respektuar kërkesat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, dhe më pas, vlerëson bazueshmërinë/meritën e aktit të shkarkimit.

Duke iu referuar çështjes objekt i këtij vendimi, procedimi administrativ, në rastin e shkarkimit të kërkuesit, përfshin tri faza: fazën e kontrollit të ushtruar nga KLSH-ja në komunën Lenie; fazën e vlerësimit të shkeljeve sipas kuadrit ligjor dhe përgatitjen e relacionit nga ana e Ministrit të Brendshëm (MB); dhe fazën e vendimmarrjes nga Këshilli i Ministrave (KM) në lidhje me shkarkimin nga detyra.

KLSH-ja pas miratimit të aktit të kontrollit, me shkresën e datës 30.06.2012, në vend që t'i drejtohej në mënyrë të drejtpërdrejtë MB-së, i cili ka kompetencën për të vlerësuar nëse shkeljet e konstatuara përbënin "shkelje të rënda të ligjit", si dhe për të përgatitur relacionin përkatës të arsyetuar, i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë me propozimin për shkarkimin nga detyra të kërkuesit. Në këtë shkresë, KLSH-ja shprehet se "Nga kontrolli i ushtruar në Komunën Lenie Gramsh, u konstatuan shkelje dhe mangësi në ushtrimin e detyrave funksionale të kryetarit të kësaj Komune, z. Astrit Bici." Pra, KLSH-ja nuk i ka cilësuar shkeljet e konstatuara si "shkelje të rënda të ligjit". Gjithashtu, në dokumentin e KLSH-së drejtuar Kryeministrit, përmenden të gjitha shkeljet e konstatuara, por nuk bëhet analiza e tyre për të vlerësuar karakterin e shkeljeve dhe për të argumentuar përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të kërkuesit.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave (SPKM), me shkresën e datës 24.07.2012, të cilën e konsideron "Urgjent", ia ka përcjellë për kompetencë Ministrit të Brendshëm, bashkëlidhur, shkresën e KLSH-së të përmendur më sipër. Sipas shkresës së SPKM-së, propozimi për shkarkimin nga detyra të kërkuesit bëhet "për shkelje të rënda ligjore në ushtrimin e funksionit dhe kompetencave", ndërkohë që dokumenti i KLSH-së, nuk e bën këtë cilësim. Në po të njëjtën ditë, datë 24.07.2012, Ministri i Brendshëm ka përgatitur projektvendimin për shkarkimin nga detyra të kërkuesit për shkelje të rënda të ligjit, së bashku me relacionin përkatës, dhe ia ka përcjellë KM-së për miratim. Vetë MB-ja, në relacionin shoqërues të projektvendimit, shprehet se "propozimi i këtij projektvendimi merr shkas nga raporti i bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dërguar Ministrisë së Brendshme me shkresën 24.07.2012...". Fakti që shkresa e KLSH-së i përcillet MB-së për kompetencë presupozon se vlerësimi i shkeljeve, nëse janë shkelje të rënda të ligjit apo jo, dhe i përgjegjësisë së kërkuesit duhej të bëhej nga MB-ja pas shqyrtimit të tyre.

Në këtë fazë të ndërmjetme, siç e ka quajtur shumica, midis momentit të përcaktimit të shkeljes dhe marrjes së vendimit për shkarkimin nga detyra, kërkuesi duhej të ishte njoftuar se ndaj tij kishte filluar një proces administrativ vlerësimi për shkarkim nga detyra dhe të njihej me shkeljet të cilat i ishin atribuar, në mënyrë që, në një ballafaqim procedural, qoftë edhe vetëm me shkrim, të mund të paraqiste kundërshtimet e tij ndaj këtyre shkeljeve. Në vlerësimin tim, fakti se kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë kontrollit të ushtruar nga KLSH-ja, është njohur paraprakisht me shkeljet dhe ka parashtruar gjatë procedurës së kontrollit pretendimet dhe argumentet e veta lidhur me konkluzionet e aktit të kontrollit, nuk përbën realizim të së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur, apo respektim të parimit të kontradiktoritetit në procesin administrativ të shkarkimit nga detyra. Ky proces nuk fillon gjatë procedurës së kontrollit nga KLSH-ja, pasi siç ka pohuar edhe shumica, propozimet e KLSH-së, si në rastin konkret ai i "shkarkimit nga detyra", nuk janë detyruese për organet të cilave u drejtohen. Shkeljet e konstatuara nga KLSH-ja mund të bëhen shkak për fillimin e procesit administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, proces, i cili fillon me fazën e vlerësimit të shkeljeve nga Ministri i Brendshëm dhe përfundon me vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave që miraton vlerësimin e bërë nga Ministri i Brendshëm. Janë pikërisht këto dy organe të cilat realizojnë, sipas kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë të pashkëputur, procesin administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve vendore. Për arsye të rolit të rëndësishëm që ato kanë, duhet të respektojnë me rigorozitet standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, relacioni i Ministrit të Brendshëm duhet të paraqesë me hollësi faktet, procesin që ka filluar për shkarkimin e organit qeverisës të pushtetit vendor, vlerësimin për shkeljet e konstatuara nëse këto përbëjnë apo jo shkelje të rënda të ligjit dhe, në mënyrë të arsyetuar, konkluzionet.



Duke pasur parasysh sa më sipër, çmuj se Ministri i Brendshëm nuk i ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. Ai nuk e ka njoftuar kërkuesin për fillimin e procesit administrativ të shkarkimit ndaj tij, duke mos i krijuar mundësinë e paraqitjes së kundërshtimeve, në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar. MB nuk është organi kompetent vendimmarrës, por është organi që përgatit raportin mbi historikun e procedimit, pretendimet e palëve dhe arsyet ligjore dhe faktike që, sipas tij, e justifikojnë vendimin e shkarkimit. Në këto kushte, dhe duke qenë se gjatë vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, kërkuesit nuk i është dhënë e drejta e parashtrimit të pretendimeve dhe debatimit mbi shkeljete vlerësuar si të rënda nga ky organ, MB-ja duhet të kishte kryer të gjitha veprimet e domosdoshme procedurale administrative, që nga njoftimi i kërkuesit mbi shkeljet e konsideruara të rënda, lënia e kohës së arsyeshme për debatim, dhe vënia në dijeni mbi iniciimin e procesit të shkarkimit nga detyra. Në këtë drejtim, propozimi i MB-së për shkarkim është i shoqëruar me projekt vendimin për shkarkim, prandaj dhe procedura e ndjekur nga ky organ nuk duhet të bënte dallim nga detyrimet procedurale të një organi vendimmarrës për respektimin e procesit të rregullt administrativ. Iniciativa e ndërmarrë nga MB-ja ishte procedurë e rëndësishme në rastin konkret, para nxjerrjes së vendimit të shkarkimit për kërkuesin, pasi ishte e vetmja procedurë që i jepte mundësinë atij të dëgjohej dhe të debatonte mbi arsyet e shkarkimit nga detyra.

Gjithashtu, fakti që relacioni shoqërues i Ministrit të Brendshëm, i është dërguar Këshillit të Ministrave brenda së njëjtës ditë kur është marrë shkresa nga KLSH-ja me shkeljet e konstatuara, krijon dyshime serioze se këto shkelje nuk janë vlerësuar nga Ministri i Brendshëm, sipas elementeve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese që i japin kuptimin e saktë dhe të drejtë konceptit “shkelje e rëndë e ligjit” (*shih vendimin nr. 15, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin konkret, shfuqizimi i vendimit të shkarkimit, ndryshe nga argumenti i shumicës që ka konkluduar se shkeljet e konstatuara nuk konsiderohen shkelje të rënda në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës, duhet të vinte si pasojë e mosrespektimit të procedurës në fazën paraprake, për arsye se Gjykata nuk mundet të korrigjojë shkeljet procedurale të kryera nga MB-ja. Kjo Gjykatë nuk zëvendëson organet e përfshira në këtë proces administrativ, por vlerëson procedurën dhe arsyet e shkarkimit, të pretenduara si të rënda nga MB-ja dhe KM-ja, si të tilla që mund ta justifikojnë shkarkimin e organit vendor. Shkelja e rëndë e ligjit është një nga kriteret e shkarkimit që duhet të vlerësohet, fillimisht, nga organet iniciuese të shkarkimit, konkretisht MB dhe pastaj KM. Për më tepër, gjatë gjykimit kushtetues, Gjykata nuk i krijoi mundësinë kërkuesit për të debatuar provat dhe faktet mbi bazën e të cilave u mbështet vendimi i KM-së për shkarkimin e tij, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit.

Si përfundim, vlerësoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, është i bazuar dhe, mbi bazën e këtij argumenti, shumica duhet të kishte shfuqizuar vendimin e KM-së.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës, për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuesi Astrit Bici është kryetar i komunës Lenie të rrethit Gramsh. Në vitin 2012, në komunën e drejtuar prej tij, u organizua një kontroll ekonomik-financiar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Nga kontrolli rezultuan një numër shkeljesh ligjore për të cilat, ndër të tjerë, ky organ kushtetues ka bërë përgjegjës edhe kërkuesin dhe, në përputhje me kompetencat e njohura nga ligji, i ka propozuar Këshillit të Ministrave marrjen ndaj tij të masës disiplinore “shkarkim nga detyra”.

2. Me vendimin nr. 458, datë 25.07.2012, me propozim të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave, pasi e ka gjetur me vend propozimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka vendosur shkarkimin e kërkuesit nga detyra e Kryetarit të Komunës.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e vendimit në fjalë të Këshillit të Ministrave, me pretendimin se ndaj tij është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor. Nga ana tjetër, sipas tij, edhe shkeljet e konstatuara nuk e justifikojnë shkarkimin nga detyra sepse nuk përmbushin kriterin e kërkuar nga neni 115 i Kushtetutës, sipas të cilit organi i zgjedhur drejtpërdrejt i

njësisë së qeverisjes vendore mund të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

4. Kërkuesi, ndonëse nuk i vë në dyshim përfundimet e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pretendon se shkeljet e konstatuara, përgjithësisht, nuk janë kryer prej tij por nga organet e varësisë dhe, mbi të gjitha, ato nuk janë të rënda në kuptimin kushtetues.

5. Duke qenë në një mendje me shumicën lidhur me rrëzimin si të pabazuar të pretendimit të kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, nuk pajtohem me të lidhur me mënyrën, shkaqet dhe këndvështrimin nga të cilat niset për të vlerësuar themelin e kërkesës. Shumica gabon kur, pasi merr në shqyrtim një për një shkeljet e ligjit në ngarkim të kërkuesit, arrin në përfundimin se asnjëra prej tyre nuk përmbush kushtin e të qenit shkelje e rëndë.

6. Shumica pranon se shkeljet e konstatuara kanë të bëjnë me çështje që lidhen me menaxhimin financiar, menaxhimin e riskut, përgatitjen e buxhetit, ndjekjen dhe zbatimin e tij, mbajtjen e dokumentacionit kontabël, procedurat e prokurimit, kontrollin e punimeve të ndërtimit, menaxhimin e të ardhurave të komunës, programet e ndihmës ekonomike, mbledhjen e taksave vendore, shpenzimet e telefonisë celulare, dhënien e dietave etj. (*shih pikën 22 të vendimit*).

7. Këto shkelje i pranon dhe kërkuesi duke shtuar, gjithashtu, se ka zbatuar të gjitha detyrat e ngarkuara në aktin e kontrollit për vënien në vend të ligjit të shkelur.

8. Jemi të mendimit se shumica gabon kur në arsyetimin e saj përpiqet të ndajë, sipas nesh në mënyre artificiale, shkeljet e kryera nga organet e varësisë me ato të kryera drejtpërdrejt nga kërkuesi, duke arritur në përfundimin se, kryesisht, shkeljet e ligjit janë kryer nga zyra e financës, komisioni i prokurimit, i inventarizimit apo dhe punonjësit e tjerë të komunës. Një ndarje e tillë është e papranueshme sepse, në kuptimin juridik, shkeljet e ligjit, që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, mund të kryen si me veprime ashtu dhe me mosveprime. Mungesa e kontrollit nga ana e kërkuesit mbi veprimtarinë e komunës që ai drejton, e ngarkon atë me përgjegjësi të plotë për të gjitha shkeljet dhe mangësitë e konstatuara.

9. Nga ana tjetër, na duket e sforcuar përpjekja e shumicës për të analizuar rëndësinë e çdo shkeljeje, duke nxjerrë përfundimin se secila prej tyre nuk është e rëndë në kuptimin kushtetues.

Së pari, nga një vështrim tërësor i raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe nga sa pranon shumica në vendim, mund të arrihet lehtë në përfundimin se gjendja e ligjshmërisë në komunën e kontrolluar, ku është kryetar kërkuesi Astrit Bici, paraqitet problematike në shumë aspekte gjë e cila nuk mund ta përjashtojë atë nga përgjegjësia dhe, në këtë kuptim, diskutimi nëse kjo përgjegjësi është e lehtë apo e rëndë shkon përtej vullnetit të kushtetutëbërësit dhe kontekstit kushtetues, lidhur me rëndësinë që ka qëndrimi ndaj ligjit në mirëfunksionimin e organeve të pushtetit vendor në një shtet të së drejtës.

Së dyti, edhe po të marrim të mirëqena përfundimet e shumicës se shkeljet e ligjit janë të lehta, ajo përsëri gabon kur nuk merr në konsideratë faktin se në kuptimin juridik doktrinar një numër shkeljesh të lehta të ligjit, për efekt të përgjegjësisë disiplinore, penale apo administrative, janë të barazvlefshme me një shkelje të rëndë të tij.

10. Nisur nga konsideratat e mësipërme, është e pavend, gjithashtu, për ligjja që shumica i bën në vendimin e saj pretendimit të kërkuesit, sipas të cilit nuk mund të kërkohet kaq shumë në zbatimin e ligjit në një komunë të thellë, me një numër të vogël banorësh, për më tepër në një rreth të vogël, kur shprehet se në komunën në fjalë ka pasur vështirësi në kuptimin dhe asimilimin e legjislacionit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si pasojë e nivelit të pamjaftueshëm financiar?! (*shih pikën 25 të vendimit*). Niveli i pamjaftueshëm në përgatitjen profesionale të stafit, është një rrethanë që shkon dhe duhet të shkojë në disfavor të kërkuesit dhe jo të për ligjë lehtësimin e tij nga përgjegjësia.

Për arsyet e mësipërme, mendojmë se duhej vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Admir Thanza, Vladimir Kristo.



VENDIM
Nr. 30, datë 27.6.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetari Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.07.2012 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 22/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kreshnik Bushi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 18/1, 42/2, 44, 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 157, datë 05.10.2001, ka caktuar ndaj kërkuarit Kreshnik Bushi masën e sigurimit “arrest me burg” për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 234, 236, 274-25 të Kodit Penal.

2. Me vendimin nr. 173, datë 22.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, është ndryshuar masa e sigurimit nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”. Kjo masë arresti ka qëndruar deri në përfundimin e gjykimit të çështjes penale.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 132, datë 13.10.2003, në zbatim të ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënie amnistie”, ka vendosur pushimin e çështjes penale për kërkuarin Kreshnik Bushi.

4. Pas këtij vendimi, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesëpadi me objekt: “Kompensim për burgim të padrejtë”.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 441, datë 12.11.2004, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë si dhe detyrimin e degës së Buxhetit të Shtetit, Laç-Kurbin, të dëmshpërblejë kërkuarin në vlerën 3 700 000 lekë si kompensim për burgim të padrejtë.

6. Mbi ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1134, datë 17.11.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 441, datë 12.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

7. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 443, datë 20.09.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, si dhe detyrimin e Thesarit të Shtetit, dega Laç, të kompensojë kërkuarin në vlerën 2 402 000 lekë.

8. Mbi ankimin e Prokurorisë së Rrethit Kurbin dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 196, datë 30.01.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

9. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

10. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

11. Kërkuesi ka parashtruar se vendimet janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Argumentet, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:

11.1. Arsyetimi i vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë është absurd e jologjik.

11.2. Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, duke cenuar të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë.

12. **Subjektet e interesuara**, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Financave, nuk paraqitën prapësime me shkrim për çështjen objekt gjykimi.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

II

13. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, paraprakisht, konstaton se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese (*shih vendimet nr. 31, datë 05.07.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

A. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit

14. Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit nr. 196, datë 30.01.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuesi ka parashtruar se vendimi është arsyetuar në mënyrë absurde dhe jologjike, duke parashtruar se çështja penale duhet të ishte pushuar për arsye se nuk provohej fajësia, dhe jo në bazë të ligjit "Për dhënie amnistie".

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës, vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 23, datë 23.07.2009, nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se një funksion tjetër i arsytimit të vendimit është t'u demonstron palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër një vendim i arsyetuar i jep mundësinë palëve ta apelojnë atë, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih*



vendimin Sarban kundër Moldavisë, prg.98, datë 4 tetor 2005). GJEDNJ-ja është shprehur për arsyetimin e vendimeve se detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështje konkrete dhe natyrës së vendimit (Hirvisaari kundër Finlandës, prg. 30, vendim i datës 27 shtator 2001).

17. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit Tiranë, në dhënien e vendimit për mospranimin e kërkesës për kompensimin e burgimit të padrejtë, është bazuar në vendimin për pushimin e çështjes penale nr. 132, datë 13.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë të jetë i paarsyetuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Kjo gjykatë në vendimin e saj ka parashtruar të gjitha pretendimet e palëve në këtë proces, ka analizuar dhe vlerësuar secilën prej tyre. Në përfundim, bazuar në kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 268 i Kodit të Procedurës Penale dhe nga ligji nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënie amnistie”, ka vlerësuar moslegjitimitimin e kërkesit në ngritjen e padisë me objekt për kompensimin e burgimit të padrejtë. Lidhur me këtë kërkesë Gjykata e Apelit Tiranë ka respektuar dhe vendimin njësuës nr. 3, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është përcaktuar rrethi i personave që legjitimohen të paraqesin padi me objekt për kompensimin e burgimit të padrejtë. Midis tyre ka përcaktuar se të drejtën për kompensim e kanë dhe “të paraburgosurit që ishin ndaluar me urdhër të prokurorit kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashtoj rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie”.

18. Gjykata arrin në përfundimin se nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm.

19. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit, për cenim të parimit të arsyetimit të vendimit, është i pabazuar.

B. Për pretendimin se vendimet janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, duke cenuar të drejtën e kompensimit për burgim të padrejtë

20. Kërkesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Ndaj tij duhet të ishte pushuar çështja penale pasi nuk provohej të kishte kryer veprat penale për të cilat akuzohej, dhe jo në zbatim të ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënie amnistie”. Duke zbatuar dispozitat e këtij ligji është cenuar e drejta për kompensimin e burgimit të padrejtë.

21. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit, si rregull, interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve, rrethanave dhe provave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*mutatis mutandis vendimi nr. 7, datë 27.04.2005 i Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 31, datë 05.07.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 dhe nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete, objekt shqyrtimi është vendimi civil i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për kompensimin e burgimit të padrejtë, dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me të cilin është vendosur mospranim rekursi. Këto vendime, ashtu sikurse u analizua më sipër, janë marrë në bazë të një vendimi penal të formës së prerë, me të cilin gjykata, bazuar në ligjin nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për dhënie amnistie” ka vendosur pushimin e çështjes penale. Ky vendim penal nuk është objekt i kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si dhe lidhur me të kërkesi nuk ka shteruar mjetet juridike.

23. Në vështrim të standardit të mësipërm, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë.

24. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkesit Kreshnik Bushi, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës¹.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Admir Thanza.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5174, datë 24.6.2013, vendosi deklarimin e vdekjes së shtetasit Hakik Mena, i biri i Xhavitit dhe i Gjylsimes, i datëlindjes 8.10.1977, lindur në Vasie, Dibër.

KËRKESË

Shtetasja Fitnete Gjoni, e bija e Ibrahimit dhe e Myneveres, lindur dhe banuese në Peqin, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të vëllait të saj shtetasit Shkëlzen Gjoni, i datëlindjes 20.6.1975, lindur në Peqin.

KËRKUESJA
Fitnete Gjoni

¹ Gjyqtarët B.Dedja, V. Kristo, A.Thanza janë shprehur për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2010-468, datë 05.03.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), pasi është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 8.7.2013
Doli nga shtypi më 8.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 28 lekë